



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:154357

Datë: 28.03.2022

Numri i dokumentit: 02848807

P.nr.1127/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e praktikantes Manjola Xhoxhaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.D. dhe Sh.D. që të dy nga Prizreni për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 (2) lidhur me par. (1), pika (1.4) e lidhur me nenin (31) i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, dhe kundër të akuzuarve M.H. nga Prizreni, dhe A.K. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 (2) lidhur me par. (1), pika (1.4) e lidhur me nenin (31) i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1494-11/2019 të datës 28.08.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Shahadin Destani, të akuzuarve B.D., Sh.D., M.H. dhe A.K. me datë 14.03.2022, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. B.D. nga i ati Sh. e ëma P. të vajzërisë H. i lindur më datë në Prizren, ku edhe jeton në rr. i martuar, babai i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mekanik, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:

2. SH.D. nga i ati B. e ëma Z. të vajzërisë E. i lindur më datë në Prizren, ku edhe jeton në rr. i martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion mekanik, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:

3. M.H. nga i ati D. e ëma B. të vajzërisë H. i lindur me datë në Prizren, ku edhe jeton në rr. i martuar – baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtorë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:

4. A.K. nga i ati K. e ëma F. të vajzërisë H. i lindur me datë në fshatin Prizren, ku edhe jeton, i martuar – baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtorë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, , i identifikuar në bazë të numrit personal:

JANË FAJTORË

I. Se me datë 17.07.2019 rreth orës 23:00, në Prizren saktësisht në lokalit e cila gjendet në objektin të akuzuarit B.D. dhe Sh.D. duke vepruar në bashkëveprim dhe me dashje, si rrjedhojë e një mosmarrëveshje të momentit dhe duke qenë nën ndikim të alkoolit, pas fjalosjes me të dëmtuarit M.H. dhe A.K. përdorin forcën ndaj të dëmtuarve, ashtu që të pandehurit të pajisur me një shishe e godasin në pjesën e kokës dhe fytyrë të dëmtuarit, nga të cilat goditje pësojnë lëndime M.H. pëson plagë shqyese në regjionin ballor, muror dhe zverkor të kokës, ndërsa A.K. pëson shenja të gjakderdhjes në kokë, fytyrë, të cilat paraqesin dëmtime të përkohshme të shëndetit, përkatësisht kualifikohen si lëndim i lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 (2) lidhur me par. (1) pika (1.4) e lidhur me nenin (31) i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

II. Se me datë 17.07.2019 rreth orës 23:00, në Prizren, saktësisht në lokalit e cila gjendet në objektin tek të pandehurit M.H. dhe A.K. duke vepruar në bashkëveprim dhe me dashje, si rrjedhojë e një mosmarrëveshje të momentit dhe duke qenë nën ndikim të alkoolit, pas fjalosjes me të dëmtuarit B.D., Sh.D. dhe H.L. përdorin ndaj të dëmtuarve, ashtu që i pandehuri M.H. i pajisur me një mjet të mprehtë – thikë fillimisht e godet në anën e majtë të gjoksit të dëmtuarin Sh.D. më pastaj e godet në regjionin i dorës së majtë të dëmtuarin B.D. e duke parë këtë përleshje ndërhyjnë i dëmtuari H.L. djali i pronares së lokalit të cekur si më lartë, ku i pandehuri A.K. e grushton në pjesën e dorës së djathtë, e nga të cilat goditje lëndime pësojnë Sh. D. i cili pëson plagë prerëse shpuese në anën e majtë të gjoksit, B.D. pëson plagë prerëse shpuese në regjionin i dorës së majtë, kurse H.L. pëson plagë shqyese në shuplakë të dorës dhe në gishta të dorës së djathtë, të cilat paraqesin dëmtime të përkohshme të shëndetit, përkatësisht kualifikohen si lëndim i lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 (2) lidhur me par. (1) pika (1.4) e lidhur me nenin (31) i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 31, 38, 39 par. 1, 40 par.1, pika 1.2, 69, 70, 71, 72 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarve B.D., Sh.D., M.H. dhe A.K.

G J Y K O N

Për veprën penale si në dispozitiv nën I./ dhe nën II./ të aktgjykimit, të akuzuarve i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, secilit veç e veç.

Në kuptim të nenit 44 të KPK-së, me pëlqimin e të akuzuarve dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) eurove, secilit veç e veç, të cilin dënim me gjobë të akuzuarit janë të obliguar ta paguajnë në tre këste mujore, duke filluar prej secilit këst nga çdo fillim i muajit 01-05 të muajit vijues, në afat prej 15 ditëve nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, secilit veç e veç.

OBLIGOHEN të akuzuarit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 eurove, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjekoligjor duhet të paguajnë shumën prej 12.50 eurove, secili veç e veç dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit duhet të paguajnë shumën prej 30 eurove, secili veç e veç, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën, **PP/II.nr.1494-11/2019 të datës 28.08.2019**, kundër të akuzuarve B.D. dhe Sh.D. që të dy nga Prizreni për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 (2) lidhur me par. (1), pika (1.4) e lidhur me nenin (31) i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, dhe kundër të akuzuarve M.H. nga Prizreni, dhe A.K. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 (2) lidhur me par. (1), pika (1.4) e lidhur me nenin (31) i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të dt. 14.03.2022, i akuzuari B.D. ka deklaruar se e pranon fajësinë duke theksuar se është penduar për një veprim të tillë, premtion dhe zotohet që kurrë më nuk do të përsërisë vepra të tilla, ka gabuar, është pajtuar me të pandehurit e tjerë dhe tani qëndrojnë në raporte të mira familjare dhe shoqërore dhe se kjo është vërejtur edhe gjatë shqyrtimit fillestar, i kanë kërkuar falje njëri tjetrit, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk kanë pasur probleme me të njëjtin, incidenti ka ndodhur nga momenti i çastit nën ndikim të alkoolit, kjo ka qenë hera e parë dhe e pa qëllimtë, është i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i vetëm i familjes dhe e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari Sh.D. ka deklaruar se e pranon fajësinë duke theksuar se është penduar për një veprim të tillë, premtion dhe zotohet që kurrë më nuk do të përsërisë vepra të tilla, ka gabuar, është pajtuar me të pandehurit e tjerë dhe tani qëndrojnë në raporte të mira familjare dhe shoqërore dhe se kjo është vërejtur edhe gjatë shqyrtimit fillestar, i kanë kërkuar falje njëri tjetrit, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk kanë pasur probleme me të njëjtin, incidenti ka ndodhur nga momenti i çastit nën ndikim të alkoolit, kjo ka qenë hera e parë dhe e pa qëllimtë, është i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i vetëm i familjes dhe e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari M.H. ka deklaruar se e pranon fajësinë duke theksuar se është penduar për një veprim të tillë, premtion dhe zotohet që kurrë më nuk do të përsërisë vepra të tilla, ka gabuar, është pajtuar me të pandehurit e tjerë dhe tani qëndrojnë në raporte të mira familjare dhe shoqërore dhe se kjo është vërejtur edhe gjatë shqyrtimit fillestar, i kanë kërkuar falje njëri tjetrit, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk kanë pasur probleme me të njëjtin, incidenti ka ndodhur nga momenti i çastit nën ndikim të alkoolit, kjo ka qenë hera e parë dhe e pa qëllim të, është i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, baba i 5 (pesë) fëmijëve, dhe se punon vetëm kur gjen punë me mëditje, mbajtës i vetëm i familjes dhe e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari A.K. ka deklaruar se e pranon fajësinë duke theksuar se është penduar për një veprim të tillë, premtion dhe zotohet që kurrë më nuk do të përsërisë vepra të tilla, ka gabuar, është pajtuar me të pandehurit e tjerë dhe tani qëndrojnë në raporte të mira familjare dhe shoqërore dhe se kjo është vërejtur edhe gjatë shqyrtimit fillestar, i kanë kërkuar falje njëri tjetrit, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk kanë pasur probleme me të njëjtin, incidenti ka ndodhur nga momenti i çastit nën ndikim të alkoolit, kjo ka qenë hera e parë dhe e pa qëllim të, është i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, baba i 4 (katër) fëmijëve, dhe se punon vetëm kur gjen punë me mëditje, mbajtës i vetëm i familjes dhe e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, i cili pranim është në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 248 të KPPK-së, e cila ka mbështetje edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I. Se me datë 17.07.2019 rreth orës 23:00, në Prizren, saktësisht në lokalit e cila gjendet në objektin tek të pandehurit B.D. dhe Sh.D. duke vepruar në bashkëveprim dhe me dashje, si rrjedhojë e një mosmarrëveshje të momentit dhe duke qenë nën ndikim të alkoolit, pas fjalosjes me të dëmtuarit M.H. dhe A.K. përdorin forcën ndaj të dëmtuarve, ashtu që të pandehurit të pajisur me një shishe e godasin në pjesën e kokës dhe fytyrë të dëmtuarit, nga të cilat goditje pësojnë lëndime M.H. pëson plagë shqyese në regjionin ballor, muror dhe zverkor të kokës, ndërsa A.K. pëson shenja të gjakderdhjes në kokë dhe fytyrë, të cilat paraqesin dëmtime të përkohshme të shëndetit, përkatësisht kualifikohen si lëndim i lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin, dhe

II. Se me datë 17.07.2019 rreth orës 23:00, në Prizren, saktësisht në lokalit cila gjendet në objektin tek të pandehurit M.H. dhe A.K. duke vepruar në bashkëveprim dhe me dashje, si rrjedhojë e një mosmarrëveshje të momentit dhe duke qenë nën ndikim të alkoolit, pas fjalosjes me të dëmtuarit B.D., Sh.D. dhe H.L. përdorin ndaj të dëmtuarve, ashtu që i pandehuri M.H. i pajisur me një mjet të mprehtë – thikë fillimisht e godet në anën e majtë të gjoksit të dëmtuarin Sh.D. më pastaj e godet në regjionin i dorës së majtë të dëmtuarin B.D. e duke parë këtë përleshje ndërhyjnë i dëmtuari H.L. djali i pronarës të lokalit të cekur si më lartë, ku i pandehuri A.K. e grushton në pjesën e dorës së djathtë, e nga të cilat goditje lëndime pësojnë Sh.D. i cili pëson plagë prerëse shpuese në anën e majtë të gjoksit, B.D. pëson plagë prerëse shpuese në regjionin i dorës së djathtë, kurse H.L. pëson plagë shqyese në shuplakë të dorës dhe në gishta të dorës së djathtë, të cilat paraqesin dëmtime të përkohshme të shëndetit, përkatësisht kualifikohen si lëndim i lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarve B.D., Sh.D., M.H. dhe A.K. të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tyre, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime të kundërligjshme si dhe marrëdhëniet e mira që kanë në mes tyre, janë pajtuar, kërkim falja ndaj njëri-tjetrit, qëndrimin e tyre korrekt gjatë procesit gjyqësor e po ashtu janë mbajtës të vetëm të familjes, si rrethanë posaçërisht rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e morri në kuptim të nenit 450 dhe 453 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Vendimi mbi kompezimin e viktimave të Krimit, gjykata e morri në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:154357, 14.03.2022

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2019:154357
Datë: 28.03.2022
Numri i dokumentit: 02848807